



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Zyra për Planifikim Strategjik - Kancelarija za strateško planiranje - Strategic Planning Office

Prishtinë, 27 korrik 2015

Nr. Ref:

Përgatitja e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim

Raport nga takimi i parë i Grupit Punues II – Qeverisja e Mirë

Procesi i përgatitjes së SKZH-së ka filluar me Vendimin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës të datës 03.06.2015, ndërsa me këtë vendim po ashtu u përcaktuan edhe grupet punuese për secilën shtyllë. Ne kemi quajtur këtë si PLAN që nënkupton: P-punësimi; L-ligji; A-afarizëm; dhe N-ndërtim. Qasje e tërësishme e këtij Plani është adresimi i sfidave më kritike që kanë të bëjnë me zhvillimin e Kosovës. Dokumenti i përgatitur do të përmbajë një pako të “prioriteteve të prioriteteve”, ndërsa implementimi i tyre do të zgjasë për pesë vitet e ardhshme (2016-2021). Pra PLAN-i është paraqitje e Faktorëve Vendimtar të Suksesit të Kosovës për rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës.

I. Pjesa e parë – Metodologjia dhe qasja

Në pjesën e parë të takimit është prezantuar qasja dhe metodologjia për hartimin e strategjisë, roli dhe funksioni i grupeve punuese, si dhe janë dhënë informata rreth procesit gjatë muajve në vijim. Në takim u qartësua se qëllimi i grupeve punuese nuk është të komentohet në materialet e prezantuara (analizat) në detaje por të identifikohen “prioritetet e prioriteteve”. Duke u bazuar në analizat e politikave të shpërndara nga ana e ZPS, grupet punuese duhet të punojnë në shqyrtimin e tyre dhe propozimin e masave të tjera të cilat mund të konsiderohen më të rëndësishme.

Roli i Grupeve Punuese - Grupet Punuese do të shqyrtojnë masat e propozuara në kuadër të analizave për secilën fushë që bie në përgjegjësinë e institucionit të tyre përkatës. Puna e Grupeve Punuese është ndihmuar me Analizat e Politikave të cilat nuk përfaqësojnë PLAN-in në versionin përfundimtar të tij, por ato janë përgatitur me qëllim që të nxisin diskutime si në kuadër të qeverisë ashtu edhe me akterë të jashtëm për atë se cilat duhet të jenë prioritetet përfundimtare të PLAN-it. Iu takon Grupeve Punuese që së pari t'i adresojnë problemet e nënvizuara dhe masat e sugjeruara në këto analiza dhe më pastaj të

marrin komentet dhe sugjerimet nga dikasteret përkatëse për çdo fushë brenda institucioneve që përfaqësojnë ato.

Në përgjithësi ky takim kishte për qëllim që anëtarët e grupit punues të familjarizohen me qasjen dhe të paraqesin komentet apo vërejtjet fillestare rreth masave të propozuara. Institucionet përgjegjëse mund të paraqesin komentet me shkrim dhe të propozojnë masa të reja brenda tri javëve duke u bazuar në këto kritere:

- **Masat e propozuar duhet të përbëjnë reforma strukturore.** Reformat përfshijnë veprime (nga politikat në legjislacion dhe zbatim) që synojnë largimin e pengesave sistematike ndaj rritjes ekonomike; konkurrueshmërisë dhe adresimin e problemeve në tregun e punës. Në këtë mënyrë, propozimet duhet të theksojnë në mënyrë të qartë se cilat pengesa sistematike të rritjes ekonomike dhe konkurrueshmërisë adresohen përmes veprimeve të propozuara. Në një fazë tjetër, ministrinë dhe institucionet tjera duhet të paraqesin ndikimin e pritshëm të masave të propozuara në kornizën makro-fiskale, konkurrueshmëri dhe punësim duke aplikuar tregues specifik.
- **Masat duhet të jenë specifike dhe të kenë afat kohor.** Masat e përgjithshme që theksojnë synime, sikurse “përmirësim” dhe “zhvillim” nuk do të merren parasysh vetëm nëse shprehen në mënyrë specifike dhe ndërlidhen me afat të caktuar kohor;
- **Masat (potencialisht) duhet të kostohen.** Ministrinë/institucionet duhet të kenë mundësi të kostojnë plotësisht masat e propozuara për çdo vit brenda periudhës 2016-2020. Masat e pakostuara nuk do të përfshihen, vetëm nëse ministrinë marrin përgjegjësinë për të kostuar propozimet.
- **Masat duhet të jenë reale nga pikëpamja e financimit.** Sa i përket tre viteve të para të financimit, kostoja e përgjithshme e masave të propozuara për secilën ministri duhet të jetë në përputhshmëri me KASH-in 2016-2018. Kostoja e zbatimit të masave mund të rritet vetëm deri në 20% deri në vitin 2020 krahasuar me vitin 2016. Në rastin e një rritjeje të tillë, propozimet nga institucioni sponsorizues duhet po ashtu të përfshijë mundësi të kursimeve në sektorë. Rritja e financimit për masat e SKZH-së nuk do të merret parasysh nëse nuk kompensohen plotësisht ose pjesërisht nga kursimet e tilla. Përndryshe, duhet të theksohen burime të tjera të financimit sikurse financimit ose asistencë teknike nga partnerët zhvillimor ose financimit i jashtëm.
- **Masat duhet të jenë të arritshme.** Propozimet nga ana e ministrive duhet të përfshijnë vetëm ato për të cilat ekziston një zotim i qartë politik të përcaktuar me programin e Qeverisë, synime të tjera të politikave të qeverisë, duke përfshirë strategjitë sektoriale dhe dokumente të tjera të politikave si dhe legjislacion. Kjo mbulon gjithashtu zotimet ndërkombëtare. Si rrjedhojë, në vitin 2016 ministrinë përgjegjëse për masat e SKZH-së do të duhet të përshtatin strategjitë sektoriale dhe planet e punës me qëllim të prioritetizimit të masave të SKZH-së. Një zotim i tillë duhet të konsiderohet gjatë propozimit të masave të reja për SKZH. Masat gjithashtu duhet të konsultohen me partnerët zhvillimor.
- **Ndërlidhja me Strategjinë e Evropës Juglindore (EJL) 2020.** Nëse është e përshtatshme, për secilën masë të propozuar duhet të paraqiten informata për ndikimin e mundshëm në caqet rajonal dhe kombëtare të Strategjisë së EJL-së 2020.
- **Prioritetizimi.** Ministrinë dhe institucionet pritëse të paraqesin propozimet e tyre (ose të komentojnë masat e propozuara nga ZPS) duket i renditur sipas renditjes prioritare duke marr parasysh gjithnjë ndikimin në konkurrueshmëri dhe punësim. Ato duhet të jenë të arritshme gjatë

periudhës së zbatimit, duke përfshirë disponueshmërinë e fondeve, qoftë përmes buxhetit të vendit ose financimit të jashtëm apo përkrahjes nga partnerët zhvillimor.

- **Bashkëpunimi.** Masat të cilat kërkojnë përpjekje të përbashkëta të disa ministrive të linjës dhe institucioneve, duhet që: a) përshkruajnë përpjekjen e përbashkët ose vizionin e politikave: por gjithashtu edhe b) të theksohet në mënyrë specifike se çfarë do të kontribuojë secili institucion për këtë masë në aspektin e zbatimit të veprimeve.

Siç është theksuar synimi është të kemi një numër të kufizuar të prioritetëve, dhe nëse propozohet ndonjë masë e re, paraqitni se cilat nga masat e propozuara nga ana jonë nuk janë relevante

II. Pjesa e Dytë – Prezantimi dhe shqyrtimi i masave

Kjo pjesë filloi me prezantimin e analizave të politikave të përgatitura nga ZPS në bashkëpunim me projektin dhe masat e rekomanduara për problemet e adresuara në këtë shtyllë. Pas prezantimit, pjesëmarrësit filluan të japin komentet fillestare të tyre dhe pothuajse të gjithë kërkuan më shumë kohë për të analizuar propozimet për dikasteret e tyre. Analizat e politikave për këtë shtyllë përfshinë këto fusha me masat e sugjeruara për secilën fushë:

1. Administratë publike në shërbim të bizneseve

- **Masa 2.01.1: Zbatimi i Ligjit për Sistemin e Lejeve dhe Licencave**

Duke zbatuar një qasje gjyotinë, të gjitha autoritetet do t'u kërkohej që të renditin licencat e tyre dhe të justifikojnë bazën e tyre ligjore. Nëse lëshimi i licencave dhe lejeve të caktuara nuk mund të justifikohet brenda një periudhe të caktuar, atëherë ata automatikisht shfuqizohen.

Ligjet specifike të sektorit që rregullojnë lëshimin e licencave dhe lejeve duhet të harmonizohen me këtë kornizë të përgjithshme ligjore.

Pas thjeshtimit të përgjithshëm rregullativ, qeveria krijon një regjistër të centralizuar 'online' të licencave dhe lejeve.

- **Masa 2.01.2: Ofrimi i shërbimeve të integruara, të orientuara kah klienti**

Qeveria ka nevojë për një vizion të ofrimit të integruar të zyrave të shërbimit fillestar dhe infrastrukturës më të mirë mbështetëse për zyrat përkrahëse:

Një inventar të plotë të të gjitha shërbimeve publike dhe një platformë të qeverisë elektronike që do të shërbente si një hapësirë e përbashkët për shkëmbimin e informacionit ndërmjet ofruesve të shërbimeve në të gjithë qeverisë;

Hapi i radhës do të ishte ndërmarrja graduale e parimit të një "raporti – shumë përdorues," duke u siguruar se bizneseve (dhe eventualisht qytetarëve) të mos u kërkohej informacionet të cilat tashmë ekzistojnë në kuadër të regjistrave dhe data bazave të shtetit.

- **Masa 2.01.3: Vendosja e inspektimeve të bazuara në rreziqe**

Qeveria duhet të kalojë një ligj të përgjithshëm kornizë që në mënyrë të qartë përcakton udhëzimet për qartësimin e bazës ligjore të aktivitetëve të inspektimit, duke zvogëluar numrin e madh të inspektimeve që bëhen aktualisht. Pas procesit të eliminimit të operacioneve të tepërta të inspektimit, krijimi i një regjistri online do të sigurojë që të gjitha inspektimet që nuk janë pjesë e regjistrit qendror nuk kanë asnjë efekt ligjor.

Autoritetet me kompetenca inspektuese duhet të koordinojnë vizitat e tyre inspektuese për më pak ndërhyrje, si dhe të kryejnë inspektime të përbashkëta të bazuara në rreziqe nëpërmjet të cilave bëhet i detyrueshëm shfrytëzimi i listave të kontrollit dhe formave të standardizuara të raportimit. Vizitat e inspektimit duhet të jenë të parashikueshme, me kohëzgjatje dhe shpeshtësi të kufizuar.

- **Masa 4: Nxitja e politikëbërjes së bazuar në fakte**

Duke inkurajuar vlerësimin e ndikimit rregullativ (VNR) në procesin e politikëbërjes, shmanget legjislacioni i panevojshëm dhe politikat e miratuara janë të qarta, konsistente, dhe të orientuara kah problemet. Duke pasur parasysh burimet e kufizuara njerëzore të qeverisë, metodologjia e VNR-së duhet të përqendrohet në analizën kosto-përfitim, duke vlerësuar shpenzimet dhe kapacitetet themelore për zbatimin e një ligji të propozuar. Zbatimi i VNRS-së duhet të ndihmojnë qeverinë për të arritur rezultate më të mëdha për çdo euro të shpenzuar. Qeveria duhet të përfshijë përfaqësuesit e komunitetit të biznesit si dhe partnerët social në të gjithë ciklin e politikave; parimi “asgjë për ta, pa ata” duhet të jetë pjesë e tërë ciklit të politikëbërjes.

2. Lufta kundër korrupsionit

- **Masa 2.02.1: Mbyllja e defekteve në sistemin e prokurimit publik**

Zhvillimi i sistemit të prokurimit elektronik, duke përfshirë infrastrukturën e TIK-ut dhe të sistemit të informacionit të menaxhimit të kontratave është një projekt aktual i mbështetur nga Banka Botërore. E-prokurimi do të ndikonte në masë të madhe në transparencën e procesit të prokurimit publik dhe, për këtë arsye, llogaridhënie. Përveç kësaj, është i nevojshëm legjislacioni dytësor për të: (i) imponuar kërkesat për dhënie e informacioneve shpjeguese për planet e prokurimit nga autoritetet kontraktuese dhe dhënie e kontratave; (ii) dekurajuar specifikimin e ulët dhe të lartë të kërkesave teknike; (iii) vendosur kriteret minimale të kualifikimit për furnizuesit potencialë (lista e bardhë); dhe (iv) dekurajuar tërheqjet dhe mos-përbushjen e kontratave të dhëna (lista e zezë).

- **Masa 2.02.2: Paktet e integritetit dhe zotimi i përbashkët i integritetit**

Çdo autoritet kontraktues duhet të obligohet të nënshkruajë një zotim integriteti me të cilin zyrtarët e prokurimit zotohen që të përmbahen nga çdo lloj sjellje korruptive. Duhet të forcohen kontrollet e brendshme në mënyrë që të ketë një shqyrtim të vazhdueshëm të zbatimit të zotimit të integritetit nga autoritetet kontraktuese vetë. Në ndërkohë, furnizuesit potencialë do të inkurajohen që të ndërmarrin një zotim të përbashkët integriteti me anë të të cilit subjektet e biznesit nga Kosova do të zotohen që të përmbahen nga sjellja e korruptuar. Politikat e tilla duhet të rrisin ndërgjegjësimin e punonjësve dhe të zhvillojnë një kuptim më të mirë të dallimit në mes të një dhurate dhe një mitoje.

3. Efikasiteti i gjyqësorit

- **Masa 2.03.1: Ulja e rasteve të shkeljeve të vogla**

Një gjë që mund të bëhet në lidhje me ngarkesën e tillë gjigante është parandalimi i grumbullimit të lëndëve nga stimulimi i zgjidhjes së shkeljeve të vogla jashtë sistemit gjyqësor. Korniza ligjore duhet të ndryshohet në mënyrë që sistemi gjyqësor të trajtoj krime të vogla vetëm nëse sanksionet janë të kontestueshme nga palët. Nën kornizën aktuale, gjambat të cilat nuk janë paguar me afat transferohen automatikisht te kundërvajtjet në gjykata. Gjykatat pastaj do të lëshojnë urdhra për kundërvajtje ndaj të cilave ende mund të ngriten ankesa, në të cilin rast iniciohet procedura gjyqësore. Kjo nuk ka nevojë të ndodh kështu: pala që ngrit rastin duhet të ketë të drejtën për të kundërshtuar një sanksion për

kundërvajtje, por në qoftë se ai ose ajo zgjedh nuk paguan gjobën, kundërvajtja do të transferohet direkt në ekzekutim. Përveç kësaj, mund të vendosen stimulime. Duke inkurajuar pagesën me kohë të gjobave përmes uljes prej 50% për gjobat e paguara brenda 72 orëve të para dhe rritjes së dënimit nëse afati i parashikuar me ligj është shkelur.

- **Masa 2.03.2: Synimi i nivelit zero të rasteve të grumbulluara:**

Është e vështirë për gjykatat për të reduktuar rastet e grumbulluara. Shumica e masave të zbatuara bazohen ekskluzivisht në caktimin e "lëndëve të vjetra" shtesë çdo muaj (kuotave), përveç ngarkesave të tyre ekzistuese. Nuk është çudi që gjykata me raste të grumbulluara të ballafaqohet me një numër në rritje të dosjeve të reja. Në rrethana të tilla, përpjekjet për të zvogëluar rastet e grumbulluara janë shpesh të pamjaftueshme dhe zakonisht zgjidhjet për problemin e vonesës janë të vështira. Strategjia Kombëtare e Reduktimit të Rasteve të Grumbulluara mbështetet në plane veprimi individuale nga ana e gjykatave për zbatim. Megjithatë, ajo do të trajtohet si një çështje me prioritet të lartë që monitorohet nga afër nga kabineti. Reduktimi i lëndëve të grumbulluara mund të përfitojë nga mbështetja shtesë përmes një rritje të përkohshme stafit për të zgjidhur rastet e vjetra. Për këtë qëllim, mund të punësohet një ekip për reduktimin e rasteve të grumbulluara prej 100 bashkëpunëtorëve profesional për të zgjidhur 90 mijë raste civile dhe penale në pritje nga fundi i vitit të kaluar.

- **Masa 2.03.3: Ruajtja e një norme pozitive të pastrimit:**

Një mënyrë alternative për zvogëlimin e lëndëve të grumbulluara është që të kërkohet rritja e efikasitetit nëpërmjet maksimizimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve. Për të arritur të njëjtin nivel të rezultatit, që është përfundimi i të gjitha rasteve të pazgjidhura civile dhe penale në vitin 2020, duhet të mbahet një normë mesatare e pastrimit prej 103% gjatë gjithë viteve deri në vitin 2020. Në mënyrë që të përmirësohet shkalla e tanishme e pastrimit prej 80 % në 103% (një rënie e kohës së përfundimit të rastit me 25%), duhet të kemi një përpjekje të konsiderueshme në maksimizimin e Sistemit të Menaxhimit të Lëndëve përmes përdorimit të TIK-ut. Zbatimi i një Sistemi të avancuar Informativ për Menaxhimin e Lëndëve të bazuar në TIK (SMIL) për gjyqësorin dhe prokurorinë e Kosovës është pjesë e Strategjisë së TIK-ut të Këshillit Gjyqësor të Kosovës 2012-2017.

III. Hapat e ardhshëm dhe konkluzionet

Ashtu siç u dakorduar edhe në takim, ZPS do të vizitojë institucionet veç e veç sipas fushës dhe brenda tri javëve anëtarët e grupit punues duhet të dërgojnë komentet, sugjerimet apo vërejtjet e tyre lidhur me secilën fushë/analizë të politikave. Arsyeja e këtyre vizitave dhe takimeve individuale me ministritë përkatëse është që edhe njëherë shkurtimisht t'ua prezantojmë analizat e politikave dhe t'u japim mundësi zyrtarëve puna e të cilëve është e ndërlidhur me fushat e adresuara në këtë proces, të kontribuojnë në këtë proces në mënyrë sa më aktive. Konkluzionet e takimit përfshijnë:

- Institucionet përgjegjëse të paraqesin komentet apo vërejtjet e tyre për masat e propozuara deri më **datë 14 gusht 2015**. Gjithashtu, brenda periudhës së theksuar institucionet mund të propozojnë masa të reja sipas kritereve të paraqitura më lartë;
- Zyra për Planifikim Strategjik do të organizoj vizita/takime individual dhe me institucionet e përfshira për të shtjelluar në hollësi masat e propozuara;
- Propozimet dhe komentet do të shërbejnë për diskutime në takimin e dytë të grupit punues;
- Takimi i radhës i grupit punues do të mbahet më së largu deri në fund të muajit gusht.